



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë  
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Ekonomisë shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar i lartë për Efiçencë Energjisë dhe bashkëprodhimit
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 1
<b>Koeficienti/Paga</b>	8
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	25/01/2023
<b>Afati për aplikim</b>	09/02/2023 - 16/02/2023
<b>Institucioni</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>Departamenti</b>	Departamenti i Energjisë
<b>Divizioni</b>	Divizioni i BRE-ve, Efiçencës dhe Bashkëprodhimit
<b>Vendi i punës</b>	Prishtinë
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00010790
<b>Kodi</b>	RPC0004454



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, ne koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse ne fushën e efijencës së energjisë dhe bashkëprodhimit;
2. Kryen detyra te parapara ne planet e punës për fushën e efijencës se energjisë dhe bashkëprodhimit të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore te caktuara;
3. Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve te specializuara te miratuara ne fushën e efijencës se energjisë dhe bashkëprodhimit;
4. Udhëheq grupet punuese ne fushën e efijencës së energjisë dhe bashkëprodhimit kur kërkohet një gjë e tillë;
5. Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda divizionit të burimeve te ripërtëritshme te energjisë, efijencës dhe bashkëprodhimit, për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive te tyre;
6. Ofron këshilla ne fushën e ekspertizës te kërkuar brenda ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë ne fushën e efijencës se energjisë dhe bashkëprodhimit;
7. Koordinon punën me pjesët tjera te ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
8. Kryen çdo detyrë tjetër ne fushën e efijencës se energjisë dhe bashkëprodhimit ne përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale te cilat mund te kërkohen ne mënyrë të arsyeshme kohe pas kohe;

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve te fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, në drejtimet e inxhinierisë (elektrike, mekanike), metalurgji, apo shkencave matematike-natyrore
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë punë profesionale brenda sektorit të energjisë

#### Të tjera:

- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri të gjuhës Angleze

### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

### 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

### 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 23/02/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

### 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- 07/03/2023 (data e përafërt), ora 10, Ministria e Ekonomisë Adresa: Sheshi Zahir Pajaziti nr.36, Prishtinë



## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

Pyetjet në Intervistë do të jenë nga Ligji për Zyrtarët Publikë si dhe nga fushëveprimtaria që mbulon Departamenti i Energjisë në fushën e efikasitetit të energjisë dhe bashkëprodhimit.

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

